

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT

SH. A.



Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini
30000
Telefoni:

Nr. 156
Pejë
039/432355

www.hidrodrini.com

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 4 të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nenit 4 të Rregullores mbi Marrëdhënjen e Punës të punëtorëve të KRU " Hidrodrini " Sh. A. Pejë, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë publikon këtë:

K O N K U R S

Pozita : Punëtorë sezonal për leximin e ujëmatësve (punë tereni) si dhe punëve të tjera të percaktuara nga sherbimi i konsumatorëve .

Ekzekutues : 13 (trembëdhjetë)

Kohëzgjatja e Kontratës për pozitat e lartëcekura është 1 (një) deri në tre (3) muaj .

(varësisht nga angazhimi që bënë i punësuar)

Puna provuese përcaktohet me Kontratën e Punës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen punët dhe detyrat që i përcaktohen nga Punëdhënësi për periudhën e kontraktuar ;
- Për punën e tij i përgjigjet Punëdhënësit. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës si në vijim :
Në rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit dhe për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës;
- Te zbatoje me korrektësi dhe përgjegjësi disiplinën në punë dhe zbatimin e detyrave të ngarkuara;

Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:

- Diploma e shkollës së mesme ;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Kopja letërnjoftimit ;
- Çertifikatën që kandidati nuk është nën hetime;

Kushtet e punës:

Sipas Marrëveshjes mes Punëmarrësit dhe Punëdhënësit.

Procedura e aplikimit :

Aplikacionet mund të merrenë në zyrën Burimeve Njerëzore të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Rr" Lekë Dukagjini" Nr.156 Pejë dhe Web – faqen " Hidrodrini" Sh. A. www.hidrodrini.com .

Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojën e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët. Aplikacioni dhe dokumentet përcjellëse dorëzohen në KRU " Hidrodrini" Sh. A. Zyra e Burimeve Njerëzore në pliko të mbyllur në adresën: Rr." Lekë Dukagjini" nr.156 - Pejë (afër Patrikanës së Pejës).

Shpallja do të jetë e hapur 15(pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit, në shtypin ditore dhe Web – faqen www.hidrodrini.com

Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale për verifikim para komisionit intervistues.

Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga zyra e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionet e derguara pas afatit të cekur më lartë nuk do të pranohe . Dokumentat jo të kompletuara do të refuzohen KRU " Hidrodrini" Sh. A. ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.